



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

NR. \_\_\_\_ . DATË \_\_\_\_ 2018

“PËR

**PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT TË  
PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE AFTËSISË SË  
KUFIZUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, gërma e, të nenit 27, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kontrolli i ndihmës ekonomike dhe pagesës për personat me aftësi të kufizuar bëhet nga struktura përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe rajonal.
2. Kontrolli i strukturave rajonale dhe me përzgjedhje në njësitë e vetqeverisjes vendore nga struktura përgjegjëse e Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror,

bazohet në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit miratohet nga titullari i institucionit sipas modelit standart të përcaktuar me Udhëzim të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

3. Kontrolli i njësive të vetqeverisjes vendore nga strukturat përgjegjëse në Shërbimin Social Shtetëror në nivel rajonal, bazohet në planin vjetor të kontrollit dhe në programet mujore në zbatim të tij. Programi i kontrollit miratohet nga titullari i institucionit sipas modelit standart të përcaktuar me Udhëzim të Ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

4. Programi i kontrollit duhet të përmbajë:

- a) Subjektet, që do të kontrollohen;
- b) Llojin e kontrollit, që do të ushtrohet;
- c) Periudhën, për të cilën do të bëhet kontrolli;
- ç) Objektivat, që duhet të realizohen.

5. Kontrolli programohet për çdo muaj dhe mund të jetë i plotë për kontrollin e njësive të vetqeverisjes vendore 1 herë në 2 vjet ose tematik sipas analizës së riskut. Në çdo rast, përpara kryerjes së kontrollit njoftohet me shkrim subjekti për fillimin e kontrollit, qëllimi, si dhe objektivat që do të realizohen.

6. Kontrolli mund të jetë i paparalajmëruar, në rastet kur ka sinjalizime për abuzime ose shkelje ligjore nga subjekti përkatës.

7. Sinjalizime konsiderohen:

- a) Njoftime me shkrim ose me mjete të tjera komunikimi të personave të interesuar për veprimtarinë e subjektit, pasi ky veprim të jetë vlerësuar si abuziv;
- b) Njoftime ose ankimime, të çdo forme, nga entet publike.
- c) Raporte specifike të gjeneruara nga sistemi.

8. Grupi i kontrollit në nivel qendror ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike mbi:

- a) veprimtarinë e strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe me përzgjedhje të strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative, të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike;

- b) procedurën e kryerjes së verifikimeve automatike në Drejtoritë Rajonale nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike dhe verifikimeve manuale nëse ka;
- c) procedurën e vendimmarrjes për familjet aplikuese dhe përfituese të ndihmës ekonomike;
- ç) kontrole tematike në njësitë vendore sipas vlerësimit të riskut dhe në zbatim të legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar.

9. Grupi i kontrollit të strukturave rajonale ushton kontroll për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike mbi:

- a) veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësi administrative të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit përkatës për ndihmën ekonomike;
- b) dokumentacionin dhe procedurën e kryerjes së aplikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike si edhe dokumentacionin në dosjen e përfituesit të ndihmës ekonomike;
- c) dokumentacionin e kategorive përfituese të ndihmës ekonomike dhe afatin e vlefshmërisë së përfitimit sipas legjislacionit në fuqi.
- ç) verifikimet social-ekonomike nëse janë kryer nga administratorët shoqërorë dhe nëse janë hedhur në sistem në rubrikën vizita në shtëpi.
- d) realizon me përzgjedhje verifikimet social-ekonomike në familje dhe vlerëson përputhshmërinë me deklarimin dhe vizitën e hedhur nga administratori shoqëror.
- dh) verifikimin e rasteve të familjeve që kanë rezultuar me deklarim të rremë dhe përjashtimi i tyre nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6 mujore sipas legjislacionit në fuqi.
- e) verifikimin e rasteve të familjeve, anëtarët madhorë të së cilës nuk janë paraqitur çdo 3 muaj për firmosjen e deklaratës 3 mujore dhe në sistem rezultojnë të paraqitur. Për rastet e mosvërtetësisë të të dhënave në sistem me atë të konstatuar në dosje, të merren masa për përjashtimin e familjeve nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6 mujore dhe propozimin për masa administrative për personat përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi.
- ë) aplikimet e familjeve që kanë në përbërjen e tyre një person me aftësi të kufizuar, invalid pune, etj.

- f) ndjekjen e arkëtimeve të shumave të patërhequra nga familjet/individët në nevojë, kur nuk tërhiqen brenda afateve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi bazuar në informacionin e Drejtorisë së Financës në bashki.
- g) përputhjen ndërmjet listëpagesave dhe thesarit, numrit të familjeve përfituese dhe shumave të përfitimit të ndihmës ekonomike;
- gj) saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;
- h) mënyrën e planifikimit të fondit të ndihmës ekonomike sipas legjislacionit në fuqi;
- i) procedurat dhe dokumentacionin e shpërndarjes së pagesave të ndihmës ekonomike për familjet që mbështeten me fondin deri në 6%, në bazë të kriteve të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
- j) dokumentacionin për përfitimin e kompensimit të energjisë elektrike dhe pagesat e përfituara nga familjet e skemës së ndihmës ekonomike.

10. Grupi i kontrollit në nivel qendror dhe rajonal ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit për PAK mbi:

- a) veprimtarinë e strukturave vendore në bashki dhe njësitë administrative të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për pagesën e aftësisë së kufizuar;
- b) dokumentacionin e përfitimeve të aftësisë së kufizuar në dosjen fizike të përfituesit;
- c) përputhjen ndërmjet listëpagesave dhe thesarit, numrit të përfituesve dhe shumave të përfitimit të pagesës për aftësinë e kufizuar;
- ç) saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;
- d) mënyrën e planifikimit të fondit të pagesave të aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit në fuqi.

11. Grupi i kontrollit harton projekt raportin për kontrollin e kryer dhe një kopje ia dorëzon subjektit të kontrolluar, i cili brenda 10 ditë pune paraqet vërejtjet apo kundërshtitë të argumentuara me dokumentacionin përkatës për projekt raportin nëse ka.

12. Raporti përfundimtar i kontrollit bëhet nga grupi i kontrollit, i cili vlerëson ose jo, komentet e subjektit të kontrolluar.

13. Titullari i insitucionit paraqet raportin përfundimtar

- a) Kryetarit të Bashkisë
- b) Prefektit të Qarkut
- c) Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror
- ç) Drejtorit Rajonal të Shërbimit Social Shtetëror

14. Në raportin përfundimtar evidentohen të gjitha shkeljet e vëna re nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë e kufizuar si dhe propozimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe masat për personat përgjegjës, si më poshtë:

- a) gjobë nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë;
- b) masë disiplinore;
- c) shpërblimin e dëmit, nëse është shkaktuar një i tillë;
- ç) kallëzim penal në rast se dyshohet se janë konsumuar elementët e veprës penale.

15. Struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar në nivel qendror, kontrollon veprimtarinë e strukturave rajonale dhe duke zbatuar metodën me përzgjedhje, kryen kontrole tematike mbi veprimtarinë e njësisive të vetqeverisjes vendore, në përputhje me programin e kontrollit, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

16. Struktura përgjegjëse për pagesat e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar në nivel rajonal, kontrollon sipas analizës së riskut dhe një herë në 2 vjet të gjitha njësitë e vetqeverisjes vendore, në përputhje me programin e kontrollit, sipas përcaktimeve në këtë vendim.

17. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për nxjerrjen e udhëzimeve mbi metodologjinë e kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike dhe metodologjinë e kontrollit të pagesave të aftësisë së kufizuar.

18. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

19. Vendimi nr. 512, datë 31.05.2006, "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

## RELACION

### PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

#### “PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projekt vendim përcakton procedurën e kryerjes së kontrollit për zbatimin e legjislacionit në fuqi për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar, me qëllim uljen e abuzivitetit dhe mirëmenaxhimin e skemës.

Objektivi kryesor është identifikimi i rasteve të mashtrimeve dhe gabimeve si dhe sanksionet që do të aplikohen.

#### II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi hartohet brenda programit analitik të akteve për vitin 2018.

#### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projektvendim hartohet për të përcaktuar mënyrën e kryerjes së kontrollit nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fuqi për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar në nivel qendror dhe rajonal. Ky projektakt parashikon përgjegjësitë e reja të strukturave kontrolluese të Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal. Projektakti gjithashtu përditëson rolin dhe funksionet e strukturave kontrolluese të Shërbimit Social Shtetëror në përputhje me ndryshimet ligjore në kompetencat e këtyre strukturave në fushën e ndihmës ekonomike dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar. Ai gjithashtu siguron përputhshmërinë e organizimit të strukturave kontrolluese të Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar.

Nuk parashikohen të dalin probleme në zbatimin e projektaktit.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar”.

Zbatimi i projektaktit garanton mbajtjen nën kontroll të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, shmangien e abuzivitetit, gabimeve dhe mashtrimeve në skemë.

#### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim hartohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, gërma e, të nenit 27, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar.

#### V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN

Projektakti nuk ka synimin përputhshmërinë me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

#### VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në pikën 1 të projektaktit përcaktohen strukturat përgjegjëse të SHSSH për kontrollin e ndihmës ekonomike dhe pagesës për personat me aftësi të kufizuar në dy nivele (qendror dhe rajonal).

Në pikën 2 dhe 3 të projektaktit parashikohen që programimi i kontroleve vjetore dhe mujore të strukturave kontrolluese të SHSSH në nivel qendror dhe rajonal për kontrollin e strukturave të vartësisë dhe pushtetin vendor, miratohet nga titullari i institucionit sipas formatit standard të përcaktuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale.

Në pikat 4, 5, 6 dhe 7 parashikohet përmbajtja e programit të kontrollit e cila konsiston në subjektet që do të kontrollohen, llojin e kontrollit (të plotë ose tematik), periudhën e kontrollit dhe objektivat që duhet të realizohen. Gjithashtu, parashikohet edhe kontrolli i paparalajmëruar në rastet kur ka sinjalizime për abuzivitet, siç janë: (i) njoftime me shkrim ose me mjete të tjera komunikimi të personave të interesuar për veprimtarinë e subjektit, pasi ky veprim të jetë

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar".



vlerësuar si abuziv, (ii) Njoftime ose ankimime, të çdo forme, nga entet publike dhe (iii) raporte specifike të gjeneruara nga sistemi.

Në pikat 8, 9 dhe 10 parashikohet kontrolli i procedurave dhe dokumentacionit që disponojnë institucionet përgjegjëse në nivel rajonal dhe vendor për zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar, nga SHSSH në nivel qendror e rajonal.

Në pikat 11, 12 dhe 13 të projektaktit parashikohen (i) afatet e observacionit nga institucionet e kontrolluara ndaj projektraportit, (ii) raporti përfundimtar (iii) dhe strukturat që vihen në dijeni për rezultatet e raportit përfundimtar të kontrollit.

Në pikën 14 parashikohet propozimi i masave administrative për shkeljet e evidentuara nga kontrolli i ushtruar. Për rastet që konstatohet se janë konsumuar elementë të veprës penale bëhet kallëzim penal pranë strukturave përgjegjëse.

Në pikat 15 dhe 16 parashikohet që pushteti vendor të kontrollohet në bazë të metodës së përzgjedhjes nga strukturat kontrolluese qendrore, ndërsa strukturat në nivel rajonal kontrollojnë të gjitha njësitë e vetqeverisjes vendore brenda vitit.

Në pikën 17 parashikohet hartimi i metodologjisë së kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike dhe metodologjisë së kontrollit të aftësisë së kufizuar, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Në pikën 18 parashikohen institucionet që ngarkohen për zbatimin e projektaktit.

Pika 19 parashikon shfuqizimin e Vendimit nr. 512, datë 31.05.2006, "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektvendimi janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetqeverisjes vendore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

---

Relacion shpjegues për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të pagesave të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar".

Projektvendimi u hartua nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ky projektvendim dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe në Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore.

#### IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk sjell efekte financiare në buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI  
OGERTA MANASTIRLIU  
MINISTËR

